



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 822 Prot.

Tiranë, më datë 17.08.2020

VENDIM

Nr. 278, datë 17.08.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, neni 48 dhe neni 134, pika 1, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit dhe raportit të monitorimit, në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 17.08.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Godinë me funksion banimi dhe shërbime 3kat + 1 kat nëntokë, faza 01, pranë rrugës “Ismail Qemali” Korçë, me aplikues projektuesit “Vitru+” sh.p.k., pronar Donika Stasa, zhvillues Bregu sh.a. dhe koncepti i monitorimit arkeologjik të realizuar nga personi i licencuar në arkeologji z. Ols Lafe;
 2. Para fillimit të punimeve për godinën faza 01 dhe faza 02 (miratuar me Vendim KKTKM Nr. 155, datë 04.06.2020) aplikuesi duhet të sjelli për miratim raportin e monitorimit;
 3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e “Godinë me funksion banim dhe shërbime 3kat + 1 kat nëntokë, faza 01, pranë rrugës “Ismail Qemali” Korçë” si dhe Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Korçë, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
 4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

